



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 107/2016, “PËR PREFEKTIN E QARKUT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 114 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Shkronja “b” e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

“b) bashkërendimin, në nivel qarku, të veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe degëve territoriale, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore, për mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore, pa cënuar autonominë vendore dhe kompetencat e organeve përkatëse;”.

Neni 2

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e nenit, pas fjalëve “organet e Policisë së Shtetit” shtohen fjalët “dhe strukturat e Policisë Bashkiake”.
2. Në pikën 4, pas fjalëve “të Policisë së Shtetit” shtohen fjalët “dhe të strukturave të Policisë Bashkiake”.

Neni 3

Në nenin 12/1 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1. Prefekti i qarkut merr pjesë në mbledhjet e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe, kur çmohet e nevojshme, propozon për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë në komunitet, në bashkërendim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet shtetërore përgjegjëse.

1/2. Prefekti i qarkut analizon problematikat e evidentuara në vendimet e marra nga mbledhjet e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe bashkërendon me institucionet përgjegjëse, masat për ndjekjen e tyre, përpara përcjelljes së informacionit pranë Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet.”

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Prefekti i qarkut merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet dhe paraqet problematikat e sigurisë në komunitet në nivel qarku, si dhe bashkërendon me institucionet përgjegjëse për ndjekjen e masave përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.”

Neni 4

Në nenin 13, pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Prefekti i qarkut bashkërendon me njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me problematikat për mbrojtjen civile dhe koordinohet me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Forcat e Armatosura për adresimin dhe zgjidhjen e tyre.”

Neni 5

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Bashkërendimi ndërinstitutional në nivel qarku

1. Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore dhe degëve territoriale që ushtrojnë veprimtari në qark, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore, për çështje me interes ndërinstitutional në nivel vendor.
2. Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre, duke respektuar parimin e autonomisë vendore.

3. *Prefekti i qarkut rrit dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qendrore, degëve territoriale dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, në nivel qarku, për çështje që kërkojnë trajtim të përbashkët.*
4. *Kur çështjet e adresuara nuk zgjidhen nga institucionet përgjegjëse, prefekti i qarkut informon ministrin përgjegjës për veprimtarinë e prefektit dhe, nëpërmjet tij, sipas rastit, Kryeministrin, për problematikat e konstatuara dhe masat e propozuara për zgjidhjen e tyre."*

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

NIKO PELESHI